




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi a) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 pika b) të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "AWA" Sh.P.K. të datës 02.05.2023 kundër njoftimit për kontratë të datës 25.04.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi me pajisje rekuizita sportive dhe pajisje të tjera për IEAA" me nr. të prokurimit 616-23-1280-1-2-1 dhe me nr. të brendshëm 616 23 037 121, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** si e palejuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "AWA" Sh.P.K. e datës 02.05.2023 kundër njoftimit për kontratë të datës 25.04.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi me pajisje rekuizita sportive dhe pajisje të tjera për IEAA" me nr. të prokurimit 616-23-1280-1-2-1 dhe me nr. të brendshëm 616 23 037 121.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "AWA" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "AWA" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 02.05.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë të datës 25.04.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi me pajisje rekuizita sportive dhe pajisje të tjera për IEAA" me nr. të prokurimit 616-23-1280-1-2-1 dhe me nr. të brendshëm 616 23 037 121.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues për këtë procedurë të prokurimit është me datë 25.04.2023. Siç është cituar edhe më sipër, kërkesa për rishqyrtim është parashtruar me datë 02.05.2023. Kjo nënkupton që është paraqitur shtatë (7) ditë pas njoftimit mbi vendimin e AK kundër të cilit është parashtruar kërkesa për rishqyrtim.

Përmes nenit 60 paragrafit 60.1 nënparagrafit b) të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik (tutje "RRPP") përcaktohet se kërkesa për rishqyrtim mund të parashtrohet sipas afatit vijues "Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit **brenda afatit prej pesë (5) ditëve pas datës së publikimit të njoftimit mbi vendimin e AK (B58) ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit në sistem të prokurimit elektronik. Në kalkulim të afateve kohore, dita e publikimit të Njoftimit mbi vendimit të AK (B58) është dita (0)**".

Në rastin konkret kërkesa për rishqyrtim është paraqitur shtatë (7) ditë pas publikimit të njoftimit mbi vendimin e AK (B58). Kjo nënkupton se kërkesa është parashtruar me dy (2) vonesë. Rrjedhimisht është gjetur se kjo kërkesë për rishqyrtim është parashtruar pas afatit të përcaktuar me nenin 60 paragrafit 60.1 nënparagrafit b) të RRPP.


Përmes nenit 62 paragrafit 62.1 të RRP përcaktohet se "Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit do ta refuzojë një kërkesë për rishqyrtim kur kërkesa nuk dorëzohet brenda afateve kohore të përcaktuara në nenin 60.1 të kësaj RRPP".

Nga sa u tha më sipër është gjetur se kërkesa për rishqyrtim është paraqitur pas afatit të përcaktuar me nenin 60 paragrafin 60.1 paragrafin b) të RRPP dhe si e tillë ajo duhet të refuzohet si palejuar përkatësisht si e pasafatshme në kuptim të nenit 62.1. paragrafit a) lidhur me nenin 63 paragrafit 63.1 nënparagrafit 63.1.1 pikës b) të RRPP.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1 nënparagrafin 63.1.1 pikën b) lidhur me nenin 62 paragrafin 62.1 nënparagrafin a) si dhe nenin 60 paragrafin 60.1. nënparagrafin b) të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 24.04.2023


Visar SHEHU
Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.